



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 08/l-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR ZËVENDESIMIN E ZYRTARES KOMUNALE PËR PERFORMANCË

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, zyrtarja komunale për performancë për fushën e planifikimit hapësinor komunal, fushën e hapësirave publike komunale dhe fushën e mbrojtjes së mjedisit Hanushe Berisha në numrin rendor gjashtë (6) e caktuar sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.016/01-6055 i datës 05.02.2025 për emërimin e koordinatorit komunal të performancës dhe zyrtarëve komunalë për performancë për fushat e caktuara në Komunën e Lipjanit për hartimin e raportit të performancës për vitin 2024, dhe në vend të saj caktohet:

ABETARE REXHEPI, nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve komunalë për performancë janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.016/01-6055 i datës 05.02.2025 për emërimin e koordinatorin komunal të performancës dhe zyrtarëve komunalë për performancë për fushat e caktuara në Komunën e Lipjanit për hartimin e raportit të performancës për vitin 2024.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Shemsi Azemit , Kordinatorit komuanal për Performancë
Abetare Rexhepi, Zyrtare Komunale për Performancë

1Nr. 016/01-6055/2
Lipjan, 12.05.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës – IADK me Nr.12-/320/01-48091 të datës 26.09.2024, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, duke u bazuar edhe në kërkesën e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi të datës 15.05.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

I. Me këtë Vendim i **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **1.500.00 €** (një mijë e pesëqind euro), Iniciativës për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK sipas kërkesës së Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi të datës 15.05.2025, me qëllim të zbatimit të plotë të Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK me Nr.12-/320/01-48091 të datës 26.09.2024.

II.Ndarja e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së plotë të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-320/01-44644 të datës 05.09.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës -IADK pasi që nga shuma e mjeteve të përcaktuara me Vendimin e Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Iniciativën për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës –IADK me Nr.12-/320/01-48091 të datës 26.09.2024 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës për transferimin e mjeteve financiare në vlerë prej 8,700.00 € është ekzekutuar vetëm pagesa në vlerë prej 7,200.00 € (shtatë mijë e dyqind euro) në vitin paraprak ndërsa ka mbetur e pa ekzekutuar pagesa në vlerë prej 1.500.00 € (një mijë e pesëqind euro).

III. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2025 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare nr 2027-000021-7128-84 në TEB Bankë në emër të IADK-së.


IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

INr. 400/01-53839/2
Lipjan, më 16.05.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIK OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN / OPSTINA LIPJAN



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

DATE/A	15.05.2025
PËR:	z. Imri Ahmetin- Kryetar i Komunës Lipjan
NGA:	z. Rexhep Rexhepi – Drejtor i Drejtoratit Për Bujqësi
LËNDA:	Kërkesë për ndryshimin e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën IADK

I nderuar Kryetar, z. Imri Ahmeti,

Me anë të kësaj shkrese, dëshirojmë t'ju informojmë në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe organizatës IADK, të formalizuar përmes një memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga kryetari i komunës me numër protokolli 01-320/01-44644, datë 05.09.2024. Ky projekt ka pasur për qëllim fuqizimin rural të komuniteteve përmes zhvillimit të bujqësisë.

Bazuar në këtë memorandum, Kuvendi Komunal ka miratuar një vendim për ndarjen e mjeteve financiare për organizatën IADK, me numër protokolli 12-320/01-48091, datë 26.09.2024, në shumën prej 8,700 shumë kjo që do të realizohet nga kategoria ekonomike e subvencioneve nga Drejtoria i Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Në vitin 2024 kanë qenë 26 përfitues, nga të cilët Komuna ka realizuar pagesa për 24 prej tyre në vlerë prej rreth 7,200 euro. Dy përfitues të mbetur nga viti i kaluar janë bartur për vitin 2025. Përveç tyre, këtë vit janë përfshirë edhe 3 përfitues të rinj, që gjithsej i bie të kemi 5 përfitues, për të cilët kërkohen edhe 1,500 euro shtesë – shumë kjo që e përmbush vlerën e plotë të vendimit të Kuvendit (8,700 euro). Për më tepër është e evidentuar edhe në raportin e ofruar nga organizata IADK.

Sipas Zyrtarit për Buxhet dhe Financa, vendimi i Kuvendit i miratuar vitin e kaluar nuk parasheh pagesën prej 1,500 eurosh të bartura për vitin 2025. Prandaj, si Drejtori e Bujqësisë, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të ndërmarrë hapat e nevojshëm për ndryshimin e këtij vendimi dhe përfshirjen e shumës prej 1,500 eurove për t'u paguar brenda këtij viti.

Faleminderit!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,280.00€**, (shtatë mijë e dyqindë e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-22422 e datës 05.05.2025, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 26 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin prill të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast $26 \times 280 = 7,280.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-22422
Lipjan, më 06.05.2025



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Rinia Fest Lipjan 2025” Nr.5-453/01-22350 të datës 02.05.2025, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Bleriana Kadriolli, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtare dhe
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Rinia Fest Lipjan 2025” Nr.5-453/01-22350 të datës 02.05.2025 të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t’i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-26047
Lipjan, më 26.05.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT ReLOaD

I. Me këtë Vendim, formohet grupi punues për zbatimin e Projektit ReLOad –faza e tretë, në vazhdim të tekstit grupi punues në përbërje si vijon:

1. Valon Pacolli, Zyrtar kryesor kontaktues me projektin ReLOad–, kryesues
2. Shehadije Ibrahim, anëtare e grupit punues
3. Vlora Krasniqi, anëtare e grupit punues,
4. Linda Shahini, anëtare e grupit punues,
5. Pranvera Krasniqi, anëtare e grupit punues
6. Ferdian Shala, anëtar i grupit punues

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit punues

Grupi punues do të bëjë zbatimin e Projektit ReLOad në bashkëpunim dhe në koordinim me organet përgjegjëse të UNDP-së, pasi që është bërë vazhdimi i fazës së tretë ku komunat e mëparshme janë ftuar të aplikojnë . Faza e tretë përfshin periudhën shkurt 2025 – janar 2029 dhe financohet nga Bashkimi Evropian (BE)) ndërsa zbatohet nga Programi i kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ku qëllimi i projektit mbetet fuqizimi dhe zgjerimi i marëdhënieve qeverisje lokale-shoqëri civile-përmes OSHC-ve përmes partneritetit me komuna duke ndihmuar rritjen e transparencës së ndarjes së fondeve publike për OSHC-të.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen anëtarët e grupit punues.

1Nr. 020/01-22154
Lipjan, më 02.05.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 , Kryetari i Komunës, merr

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, anëtari i Komisionit komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar në numrin rendor dhjetë (10) Lorik Bërbatovci nga QPS i caktuar, sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar 1Nr.020/04-54604 i datës 07.10.2022, për shkak të transferimit në Drejtoratin tjetër dhe në vend të tij caktohet:

ZYRAFETE MAVRIQI-BYTYQI, nga Qendra për Punë Sociale -Lipjan.

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar zyrtarëve komunalë janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komisionit komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar 1Nr.020/04-54604 i datës 07.10.2022.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Shkëlzen Hajdinit, Drejtor i DSHPS Kyesues i Komisionit
Zyra Lokale për Komunitete
Zyrafete Mavriqi-Bytyqi

1Nr. 020/04-54604/2
Lipjan, 13.05.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-të për Thirrje publike "Java e Kulturës në Komunën e Lipjanit Nr.5-453/01-26996 të datës 30.05.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ "LIPJAN YOUTH CENTER -LYC"

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 4,500.00 € (katër mijë e pesëqind euro), për t'a mbështetur financiarisht OJQ-në "Lipjan Youth Center" LYC, e cila ka aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-19638 të datës 17.04.2025 (Java e Kulturës në Komunën e Lipjanit), të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja e cila do të mbështetet financiarisht nga Komuna.

Nr.	Emërtimi i OJQ-së)	Shuma
1.	LIPJAN YOUTH CENTER -LYC	4,500.00 €
	Shuma Totale	4,500.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2025 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 453/01-26996/2
Lipjan, më 30.05.2025

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për fushën e Kulturës, Rinisë, (Java e Kulturës në Komunën e Lipjanit) dhe përmbushjen e objektiv të thirrjes publike në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-19638 të datës 17.04.2025, në përbërje si vijon:

1. Fadil Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Adelina Rexhepi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ganimete Osmani, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertës, anëtare
6. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezerv

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për fushën e Kulturës, Rinisë, (Java e Kulturës në Komunën e Lipjanit) dhe përmbushjen e objektiv të thirrjes publike në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-19638 të datës 17.04.2025, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-25130
Lipjan, më 20.05.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-014946 e datës 04.04.2025, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-014946 e datës 04.04.2025 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari për ndarjen e frezave për traktor, shpërndarsve të plehut dhe spërkatëse 400 L për vitin 2025, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesuese
2. Hazbi Ademi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Merita Zeqiri Magashi, Drejtorati për Arsim, anëtare

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për fermerë përkatësisht për freza për traktor, shpërndarse të plehut dhe spërkatëse 400 L për vitin 2025 të cilët kan aplikuar sipas shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-014946 e datës 04.04.2025 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-014946 e datës 04.04.2025.

- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-23714
Lipjan, 13.05.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar me: Priljeno: 20		
Mjesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 1

Me këtë Vendim, Lorik Berbatovci, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, CAKTOHET Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve Lipjan Youth Center-LYC, për Thirrjen publike Nr.5-453/01-19638 të datës 17.04.2025 (Java e Kulturës në Komunën e Lipjanit), të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratës së OJQ-së përfituese të subvencioneve Lipjan Youth Center-LYC, konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Lorik Berbatovci dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

INr. 01-112/02-27116

Lipjan, më 30.05.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

